<p>2.5. Nxiti, promovon dhe lehtëson kthimin e potencialit intelektual të diasporës në Kosovë;</p> <p>2.6. Mbështet themelimin e mekanizmave të komunikimit me diasporën dhe shërben si urë lidhëse ndërmjet tyre dhe institucioneve të Republikës së Kosovës;</p> <p>2.7. Koordinon të gjitha aktivitetet e institucioneve të Republikës së Kosovës për diasporën.</p> <p>3. Drejtori i Departamentit për Diasporë raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>4. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë këto divizione:</p> <p>4.1. Divizioni për Komunikim dhe Koordinim me Diasporë;</p> <p>4.2. Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë;</p> <p>4.3. Divizioni për Arsim në Diasporë.</p> <p>5. Numri i të punësuarve në Departamentin për Diasporë është katërmëdhjetë (14).</p>	<p>2.5. Encourage, promote and facilitate the return of the intellectual potential of the diaspora to Kosovo;</p> <p>2.6. Support the establishment of communication mechanisms with the diaspora and serve as a bridge between them and institutions of the Republic of Kosovo;</p> <p>2.7. Coordinate all activities of the institutions of the Republic of Kosovo for the diaspora.</p> <p>3. Director of the Department of Diaspora shall report to the Secretary General.</p> <p>4. The following Divisions shall be part of this Department:</p> <p>4.1. Division for Communication and Coordination with the Diaspora;</p> <p>4.2. Division for Culture, Youth and Sports in the Diaspora;</p> <p>4.3. Division for Education in the Diaspora.</p> <p>5. The number of employees in the Department of Diaspora shall be fourteen (14).</p>	<p>2.5. Podstiče, promovise i olakšava povratak intelektualnog potencijala dijasporu na Kosovu;</p> <p>2.6. Podržava uspostavljanje mehanizama komunikacije sa dijasporom i služi kao most između njih i institucija Republike Kosovo;</p> <p>2.7. Koordinira sve aktivnosti institucija Republike Kosovo za dijasporu.</p> <p>3. Direktor Odeljenja za dijasporu izveštava generalnom sekretaru.</p> <p>4. U okviru ovog Odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p> <p>4.1. Odsek za komunikaciju i koordinaciju sa dijasporom;</p> <p>4.2. Odsek za kulturu, omladinu i sport u dijaspori;</p> <p>4.3. Odsek za obrazovanje u dijaspori.</p> <p>5. Broj zaposlenih u Odeljenju za dijasporu je četrnaest (14).</p>
--	---	---

<p style="text-align: center;"><b>Neni 34</b> <b>Divizioni për Koordinim dhe</b> <b>Komunikim me Diasporë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 34</b> <b>Division for Coordination and</b> <b>Communication with the Diaspora</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 34</b> <b>Odsek za koordinaciju i komunikaciju</b> <b>sa dijasporom</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Koordinim dhe Komunikim me Diasporë janë:</p> <p>1.1. Ndhmon krijimin e mekanizmit institucional të komunikimit me diasporën;</p> <p>1.2. Përgatit dhe organizon programe dhe projekte që synojnë krijimin, mbështetjen, fuqizimin dhe unifikimin e shoqatave, rrjeteve dhe formave të tjera të organizimit të diasporës;</p> <p>1.3. Nxit themelimin dhe përkrah punën e Këshillit (konsultativ) të Diasporës, shërben si urë lidhëse ndërmjet Këshillit dhe institucioneve të Kosovës;</p> <p>1.4. Nxit dhe promovon kthimin e potencialit intelektual të pjesëtarëve të diasporës në Kosovë;</p> <p>1.5. Angazhohet për identifikimin e kërkesave të institucioneve përkatëse për nevojat e angazhimit të ekspertëve nga diaspora;</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Coordination and Communication with the Diaspora shall be as follows:</p> <p>1.1. Help to establish the institutional mechanism of communication with the diaspora:</p> <p>1.2. Prepare and organize programs and projects aimed at creating, supporting, empowering and unifying associations, networks and other forms of diaspora organization;</p> <p>1.3. Encourage the establishment and support the work of the (consultative) Council of Diaspora, serve as a bridge between the Council and Kosovo institutions;</p> <p>1.4. Encourage and promote the return of intellectual potential of members of the diaspora to Kosovo;</p> <p>1.5. Engage in identifying requirements of relevant institutions for the needs of engaging experts from the diaspora;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za koordinaciju i komunikaciju sa dijasporom:</p> <p>1.1. Pomaže u uspostavljanju institucionalnog mehanizma komunikacije sa dijasporom:</p> <p>1.2. Priprema i organizuje programe i projekte koji imaju za cilj stvaranje, podršku, osnaživanje i objedinjavanje udruženja, mreža i drugih oblika organizovanja dijaspore;</p> <p>1.3. Podstiče osnivanje i podržava rad (konsultativnog) Saveta za dijasporu, služi kao most između Saveta i kosovskih institucija;</p> <p>1.4. Podstiče i promoviše povratak intelektualnog potencijala pripadnika dijaspore na Kosovu;</p> <p>1.5. Angažuje se na identifikovanju zahteva relevantnih institucija za potrebe angazovanja stručnjaka iz dijaspore;</p>

<p>1.6. Bashkëpunon me misionet diplomatike, organizatat joqeveritare dhe botën akademike lidhur me angazhimin e potencialit intelektual nga diaspora në Kosovë;</p> <p>1.7. Koordinohet me institucionet përgjegjëse të Republikës së Kosovës lidhur me kërkesat dhe të drejtat të diasporës.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Koordinim dhe Komunikim me Diasporën raporton të drejtori i Departamentit për Diasporë.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Koordinim dhe Komunikim me Diasporën është tre (3).</p>	<p>1.6. Cooperate with diplomatic missions, non-governmental organizations and academia regarding engagement of intellectual potential from the diaspora in Kosovo;</p> <p>1.7. Coordinate with responsible institutions of the Republic of Kosovo regarding requests and rights of the diaspora.</p> <p>2. Head of the Division for Coordination and Communication with the Diaspora shall report to the Director of the Department of Diaspora.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Coordination and Communication with the Diaspora shall be three (3).</p>	<p>1.6. Sarađuje sa diplomatskim misijama, nevladinim organizacijama i akademskim krugovima u vezi sa angažovanjem intelektualnih potencijala dijasporë na Kosovu;</p> <p>1.7. Koordinira sa nadležnim institucijama Republike Kosovo u vezi sa zahtevima i pravima dijasporë.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za koordinaciju i komunikaciju sa dijasporom odgovara direktoru Odeljenja za dijasporu.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za koordinaciju i komunikaciju sa dijasporom je tri (3).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 35</b> <b>Divizioni për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 35</b> <b>Division for Culture, Youth and Sports in the Diaspora</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 35</b> <b>Odsek za kulturu, omladinu i sport u dijaspori</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë janë:</p> <p>1.1. Përmes aktiviteteve kulturore në Kosovë dhe në vendet ku jeton diaspora, synon ruajtjen dhe zhvillimin e vlerave kulturore te pjesëtarët e diasporës;</p> <p>1.2. Përgatit, zbaton dhe mbikëqyr realizimin e programeve, projekteve që</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Culture, Youth and Sports in the Diaspora shall be as follows:</p> <p>1.1. Aim to preserve and develop cultural values of members of the diaspora, through cultural activities in Kosovo and in countries where the diaspora lives;</p> <p>1.2. Prepare, implement and supervise implementation of programs, projects</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za kulturu, omladinu i sport u dijaspori:</p> <p>1.1. Kroz kulturne aktivnosti na Kosovu i u zemljama u kojima živi dijaspora, ima za cilj očuvanje i razvoj kulturnih vrednosti pripadnika dijasporë;</p> <p>1.2. Priprema, sprovodi i nadgleda realizaciju programa, projekata koji se</p>

<p>kanë të bëjnë me kulturën, rininë dhe sportin në diasporë;</p> <p>1.3. Ndihmon realizimin e manifestimit “Ditët e kulturës së Kosovës” në diasporë dhe “Ditët e Mërgatës” në Kosovë;</p> <p>1.4. Mbështet themelimin e Qendrave Kulturore në Diasporë;</p> <p>1.5. Në bashkëpunim me Departamentin për Diplomaci Publike dhe me misionet diplomatike dhe konsullore, promovon trashëgiminë kulturore të Kosovës në vendet ku jeton diaspora e Kosovës;</p> <p>1.6. Organizon dhe mbështet aktivitetet sportive dhe rinore në diasporë përmes klubeve sportive, shoqatave dhe rrjeteve të të rinjve në diasporë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë raporton te drejtori i Departamentit për Çështje të Diasporë.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Kulturë, Rini dhe Sport në Diasporë është pesë (5).</p>	<p>related to culture, youth and sports in the diaspora;</p> <p>1.3. Assist in the implementation of the manifestation "Days of Kosovo Culture" in the diaspora and "Days of Diaspora" in Kosovo;</p> <p>1.4. Support the establishment of Cultural Centres in the Diaspora;</p> <p>1.5. In cooperation with the Department of Public Diplomacy and diplomatic and consular missions, promote the cultural heritage of Kosovo in the countries where the Kosovo diaspora lives;</p> <p>1.6. Organize and support sports and youth activities in the diaspora through sports clubs, associations and youth networks in the diaspora.</p> <p>2. The Head of the Division for Culture, Youth and Sports in the Diaspora shall report to the Director of the Department of Diaspora Affairs.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Culture, Youth and Sports in the Diaspora shall be five (5).</p>	<p>odnose na kulturu, omladinu i sport u dijaspori;</p> <p>1.3. Pomaže u realizaciji manifestacije „Dani kulture Kosova“ u dijaspori i „Dani dijasporë“ na Kosovu;</p> <p>1.4. Podržava osnivanje kulturnih centara u dijaspori;</p> <p>1.5. U saradnji sa Odeljenjem za javnu diplomatiju i diplomatskim i konzularnim misijama, promovise kulturno nasleđe Kosova u zemljama u kojima živi kosovska dijaspora;</p> <p>1.6. Organizuje i podržava sportske i omladinske aktivnosti u dijaspori preko sportskih klubova, udruženja i omladinskih mreža u dijaspori.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za kulturu, omladinu i sport u dijaspori odgovara direktoru Odjeljenja za dijasporu.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za kulturu, omladinu i sport u dijaspori je pet (5).</p>
--	---	---



<p style="text-align: center;"><b>Neni 36</b> <b>Divizioni për Arsim në Diasporë</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 36</b> <b>Division for Education in the Diaspora</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 36</b> <b>Odsek za obrazovanje u dijaspori</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Arsim në Diasporë janë:</p> <p>1.1. Ndhmon krijimin e kushteve për ruajtjen dhe institucionalizimin e mësimi të gjuhëve zyrtare të Republikës së Kosovës dhe gjuhët e komuniteteve të tjera, në të cilat zhvillohet sistemi arsimor në Kosovë;</p> <p>1.2. Krijon programin gjithëpërfshirës arsimor për pjesëtarë të diasporës (në bazë të kurrikulës së re, hartimi dhe botimi i teksteve shkollore të përbashkëta);</p> <p>1.3. Organizon fushata sensibilizuese, takime të drejtpërdrejta, promovim të aktiviteteve të përbashkëta, si botimi i revistave të përbashkëta, transmetim të spoteve promovuese, botim të broshurave dhe posterëve, organizim të emisioneve në radio dhe televizion për mësimin plotësues në diasporë, etj.;</p> <p>1.4. Propozon marrëveshje me shtetet ku gjendet diaspora për zhvillimin e mësimi të gjuhës dhe kulturës amtare në diasporë;</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Education in the Diaspora shall be as follows:</p> <p>1.1. Assist in creating conditions for preservation and institutionalization of learning official languages of the Republic of Kosovo and languages of other communities in which the education system in Kosovo develops;</p> <p>1.2. Create a comprehensive educational program for members of the diaspora (based on the new curriculum, drafting and publishing joint textbooks);</p> <p>1.3. Organize awareness campaigns, face-to-face meetings, promotion of joint activities, such as publishing joint magazines, broadcasting promotional clips, publishing brochures and posters, organizing radio and television shows for supplementary education in the diaspora, etc.;</p> <p>1.4. Propose agreements with countries where diaspora is located for development of mother tongue and culture learning in diaspora;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za obrazovanje u dijaspori:</p> <p>1.1. Pomaže u stvaranju uslova za očuvanje i institucionalizaciju učenja službenih jezika Republike Kosovo i jezika drugih zajednica u kojima se razvija sistem obrazovanja na Kosovu;</p> <p>1.2. Kreira sveobuhvatan program obrazovanja za pripadnike dijaspore (na osnovu novog nastavnog plana i programa, izrada i izdavanje zajedničkih udžbenika);</p> <p>1.3. Organizuje kampanje podizanja svesti, direktne sastanke, promociju zajedničkih aktivnosti, kao što su izdavanje zajedničkih časopisa, emitovanje promotivnih spotova, izdavanje brošura i postera, organizovanje radio i televizijskih emisija za dopunsko obrazovanje u dijaspori itd;</p> <p>1.4. Predlaže sporazume sa zemljama u kojima se nalazi dijaspora za razvoj nastave maternjeg jezika i kulture u dijaspori;</p>

<p>1.5. Në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Arsimit, ngrit vazhdimisht cilësinë dhe zhvillimin profesional të mësimeve përmes seminareve, trajnimeve, etj.;</p> <p>1.6. Në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Arsimit, bën shpërndarjen e librave të veçantë, librave letrarë, kulturorë dhe të trashëgimisë kulturore për mësimin e gjuhëve zyrtare dhe të kulturës së Kosovës, furnizon libra dhe mjete të tjera arsimore, hap dhe pasuron bibliotekat në diasporë, si dhe krijon dhe fuqizon këshilla të arsimtarëve në diasporë;</p> <p>1.7. Në bashkëpunim me Ministrinë përkatëse të Arsimit, ofron qasje në një platformë didaktike për mësimin e gjuhës amtare, në distancë, për pjesëtarë të diasporës;</p> <p>1.8. Mbështet hapjen e shkollave/paraleleve të reja, ofron mbështetje për organizimin e mësimin plotësues në gjuhën amtare në shkollat ekzistuese në diasporë dhe punon për rritjen e numrit të nxënësve;</p> <p>1.9. Propozon dhe organizon programe vjetore me aktivitete të edukimit joformal për pjesëtarë të diasporës (kampe dhe shkolla verore, ekskursionet)</p>	<p>1.5. In cooperation with the relevant Ministry of Education, continuously enhance quality and professional development of teachers through seminars, trainings, etc.;</p> <p>1.6. In cooperation with relevant Ministry of Education, distribute special books, literary, cultural and cultural heritage books for learning the official languages and culture of Kosovo, supply books and other educational tools, open and enrich libraries in the diaspora, and create and empower teachers' councils in the diaspora;</p> <p>1.7. In cooperation with the relevant Ministry of Education, provide access to a didactic platform for distance learning of the mother tongue for members of the diaspora;</p> <p>1.8. Support the opening of new schools/classes, provide support for the organization of supplementary education in the mother tongue in existing schools in the diaspora and work to increase the number of students;</p> <p>1.9. Propose and organize annual programs with non-formal education activities for members of the diaspora (camps and summer schools, educational</p>	<p>1.5. U saradnji sa resornim Ministarstvom obrazovanja kontinuirano unapređuje kvalitet i stručno usavršavanje nastavnika kroz seminare, obuke itd;</p> <p>1.6. U saradnji sa resornim Ministarstvom obrazovanja distribuirana posebne udžbenike, književne, kulturne i udžbenike kulturne baštine za učenje službenih jezika i kulture Kosova, snabdeva udžbenicima i drugim obrazovnim sredstvima, otvara i obogaćuje biblioteke u dijaspori, kao i stvara i osnažuje nastavnička veća u dijaspori;</p> <p>1.7. U saradnji sa resornim Ministarstvom obrazovanja obezbeđuje pristup didaktičkoj platformi za učenje maternjeg jezika na daljinu, za pripadnike dijaspore;</p> <p>1.8. Podržava otvaranje novih škola/odeljenja, pruža podršku organizaciji dopunske nastave na maternjem jeziku u postojećim školama u dijaspori i radi na povećanju broja učenika;</p> <p>1.9. Predlaže i organizuje godišnje programe sa aktivnostima neformalnog obrazovanja pripadnika dijaspore (kampovi i letnje škole, edukativne</p>
--	---	--

<p>mësimore njohëse në vendlindje, kuize të diturisë, festival për fëmijët e diasporës në atdhe, manifestime kulturore dhe sportive në atdhe dhe diasporë, si olimpiada sportive, etj.);</p> <p>1.10. Krijimi, rrjetëzimi dhe fuqizimi i këshillave të arsimtarëve në diasporë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Arsim në Diasporë raporton te drejtori i Departamentit për Diasporë.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionit për Arsim në Diasporë është pesë (5).</p>	<p>- introductory excursions in the homeland, knowledge quizzes, festivals for diaspora children in the homeland, cultural and sports events in the homeland and diaspora, such as sports, Olympiads , etc.);</p> <p>1.10. Create, network and empower teachers' councils in the diaspora.</p> <p>2. Head of Division for Education in the Diaspora shall report to the Director of the Department of Diaspora.</p> <p>3. Number of employees in the Division for Education in the Diaspora shall be five (5).</p>	<p>ekskurzije u domovini, kvizovi znanja, festivali za decu dijaspore u domovini, kulturne i sportske manifestacije u domovini i dijaspori, kao što je sportska olimpijada itd.);</p> <p>1.10. Stvaranje, umrežavanje i osnaživanje nastavničkih veća u dijaspori.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za obrazovanje dijaspore odgovara direktoru Odeljenja za dijasporu.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za obrazovanje u dijaspori je pet (5).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 37</b> <b>Departamenti i Protokollit të Shtetit</b></p> <p>1. Protokollit i Shtetit përfaqëson përmbledhjen institucionale të kriterëve që rregullojnë çdo aspekt të natyrës formale dhe joformale të marrëdhënieve zyrtare. Për zbatimin e këtyre kriterëve është kompetent Protokollit i Shtetit. Protokollit i Shtetit është zyra kompetente që përcakton dhe trajton protokollin dhe ceremonialin zyrtar në Republikën e Kosovës.</p> <p>2. Protokollit i Shtetit kryen detyrën e zbatimit të ceremonialit zyrtar dhe veprimtarisë protokollare të Presidentit të Republikës, Kryetarit të Kuvendit,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 37</b> <b>Department of State Protocol</b></p> <p>1. The State Protocol shall represent the institutional summary of the criteria governing every aspect of the formal and informal nature of official relations. The State Protocol shall be competent for the implementation of these criteria. The State Protocol shall be the competent office that determines and handles the official protocol and ceremonial in the Republic of Kosovo.</p> <p>2. The State Protocol shall perform the task of implementing the official ceremonial and protocol activity of the President of the Republic, the Chairperson of the Assembly,</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 37</b> <b>Odeljenje za državni protokoll</b></p> <p>1. Državni protokoll predstavlja institucionalni zbir kriterijuma koji regulišu svaki aspekt formalne i neformalne prirode zvaničnih odnosa. Za sprovođenje ovih kriterijuma nadležan je Državni protokoll. Državni protokoll je nadležna kancelarija koja utvrđuje i vodi zvanični protokoll i ceremonijal u Republici Kosovo.</p> <p>2. Državni protokoll obavlja poslove sprovođenja službene ceremonijalne i protokolarne delatnosti predsednika Republike, predsednika Skupštine,</p>

<p>Kryeministrin dhe Ministrinë së Punëve të Jashtme për veprimtarinë e tyre brenda dhe jashtë vendit.</p>	<p>the Prime Minister and the Ministry of Foreign Affairs for their activities inside and outside the country.</p>	<p>premijera i Ministarstva inostranih poslova za njihove aktivnosti u zemlji i inostranstvu.</p>
<p>3. Detyrat dhe Përgjegjësitë e Departamentit të Protokollit të Shtetit janë:</p>	<p>3. Duties and Responsibilities of the Department of State Protocol shall be as follows:</p>	<p>3. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za državni protokol:</p>
<p>3.1. Zbaton me saktësi radhën e përparësisë së rangjeve zyrtare të Republikës së Kosovës, misioneve diplomatike, si dhe e përcakton atë në rastet e veçanta, të paparashikuara në këtë ligj. Kriteri themelor i funksionimit të kësaj strukture është respektimi i rangut zyrtar;</p>	<p>3.1. Precisely implement the order of priority of the official ranks of the Republic of Kosovo, diplomatic missions, as well as determine it in special cases, when not provided for in this Law. The basic criterion for the functioning of this structure shall be the observance of the official rank.</p>	<p>3.1. Tačno sprovodi red prvenstva zvaničnih rangova Republike Kosovo, diplomatskih misija, kao i utvrđuje ga u posebnim slučajevima, koji nisu predviđeni ovim zakonom. Osnovni kriterijum za funkcionisanje ove strukture je poštovanje zvaničnog ranga.</p>
<p>3.2. Organizon dhe ndjek ceremonitë e pritjes e të përcjelljes së delegacioneve të huaja të rangut: President, Kryetar i Kuvendit, Kryeministër dhe Ministër i Punëve të Jashtme; në bashkëpunim me kabinetet e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrin dhe Ministrin të Punëve të Jashtme, harton programin e vizitës së tyre dhe përgjigjet për zbatimin e tij;</p>	<p>3.2. Organize and attend the reception and escort ceremonies of foreign delegations of the following ranks: President, Chairperson of the Assembly, Prime Minister and Minister of Foreign Affairs; in cooperation with the cabinets of the President, the Chairperson of the Assembly, the Prime Minister and the Minister of Foreign Affairs, draft the program of their visit and be responsible for its implementation.</p>	<p>3.2. Organizuje i prati svečanosti prijema i pratnje stranih delegacija ranga: predsednika, predsednika Skupštine, premijera i ministra inostranih poslova; u saradnji sa kabinetima predsednika, predsednika Skupštine, premijera i ministra inostranih poslova, sačinjava program njihove posete i odgovorno je za njegovo sprovođenje.</p>
<p>3.3. Përgatit anën protokollare të Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrin dhe të Ministrin të Punëve të Jashtme të Republikës së Kosovës për vizitat zyrtare jashtë shtetit. Protokollin i Shtetit, në bashkëpunim me përfaqësitë</p>	<p>3.3. Prepare the protocol aspects of the President, the Chairperson of the Assembly, the Prime Minister and the Minister of Foreign Affairs of the Republic of Kosovo for official visits abroad. The State Protocol shall, in</p>	<p>3.3. Priprema protokolarnu stranu predsednika, predsednika Skupštine, premijera i ministra inostranih poslova Republike Kosovo za zvanične posete inostranstvu. Državni protokol, u saradnji sa diplomatskim misijama</p>

<p>diplomatike të Republikës së Kosovës dhe me institucionin homolog të shtetit pritës, përpunon programin e vizitës së personaliteteve të mësipërme.</p> <p>3.4. Përgjigjet për organizimin e ceremonive për festat zyrtare, memorialë, shtetërorë dhe lokale, në rastet kur ato janë jubilarë dhe kur për organizimin e të cilave, me vendim të Qeverisë të Republikës së Kosovës, krijohet një komision shtetëror;</p> <p>3.5. Përcakton mënyrën e përdorimit të simboleve shtetërore, flamurit, himnit, stemës dhe shenjave të tjera zyrtare sipas Ligjit për përdorimin e simboleve shtetërore të Republikës së Kosovës;</p> <p>3.6. Bashkërendon takimet e Presidentit, Kryetarit të Kuvendit, Kryeministrit dhe të Ministrit të Punëve të Jashtme dhe të Ministrave tjerë me përfaqësuesit diplomatikë të akredituar në Republikën e Kosovës.</p> <p>4. Drejtori i Departamentit të Protokollit të Shtetit raporton te Sekretari i Përgjithshëm.</p> <p>5. Në kuadër të këtij Departamenti bëjnë pjesë këto divizione:</p>	<p>cooperation with the diplomatic missions of the Republic of Kosovo and with the counterpart institution of the host country, elaborate the program of the visit of the above-mentioned personalities;</p> <p>3.4. Be responsible for organizing ceremonies for official, memorial, state and local holidays, in cases when they are jubilee and when, for the organization of which, by decision of the Government of the Republic of Kosovo, a state commission is established;</p> <p>3.5. Define the manner of use of state symbols, flag, anthem, emblem and other official signs according to the Law on Use of State Symbols of the Republic of Kosovo;</p> <p>3.6. Coordinate the meetings of the President, the Chairperson of the Assembly, the Prime Minister and the Minister of Foreign Affairs and other Ministers with the diplomatic representatives accredited in the Republic of Kosovo.</p> <p>4. The Director of the Department of State Protocol shall report to the Secretary General.</p> <p>5. The following Divisions shall be part of this Department:</p>	<p>Republike Kosovo i sa partnerskom institucijom zemlje domaćina, razrađuje program posete gore navedenih ličnosti.</p> <p>3.4. Odgovorno je za organizovanje zvaničnih praznika, memorijala, državnih i lokalnih praznika, u slučajevima kada su jubilarni i za čije se organizovanje, odlukom Vlade Republike Kosovo, osniva državna komisija;</p> <p>3.5. Definiše način upotrebe državnih simbola, zastave, himne, grba i drugih zvaničnih znakova u skladu sa Zakonom o upotrebi državnih simbola Republike Kosovo;</p> <p>3.6. Koordinira sastanke predsednika, predsednika Skupštine, premijera i ministra inostranih poslova i drugih ministara sa diplomatskim predstavnicima akreditovanim u Republici Kosovo.</p> <p>4. Direktor Odeljenja za državni protokol odgovara generalnom sekretaru.</p> <p>5. U okviru ovog Odeljenja nalaze se sledeći odseci:</p>
---	--	---

<p>5.1. Divizioni i Ceremonialit, dhe</p> <p>5.2. Divizioni për Korrespondenca dhe Privilege Diplomatike.</p> <p>6. Numri i të punësuarve në Departamentin e Protokollit të Shtetit është nëntë (9).</p>	<p>5.1. Division for Ceremonial and</p> <p>5.2. Division for Diplomatic Correspondence and Privileges.</p> <p>6. The number of employees in the Department of State Protocol shall be nine (9).</p>	<p>5.1. Odsek za ceremonije</p> <p>5.2. Odsek za prepisku i diplomatske privilegije.</p> <p>6. Broj zaposlenih u Odeljenju za državni protokol je devet (9).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 38</b> <b>Divizioni i Ceremonialit</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 38</b> <b>Division for Ceremonial</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 38</b> <b>Odsek za ceremonije</b></p>
<p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit të ceremonialit janë:</p> <p>1.1. Përpilon planprogramin e divizionit;</p> <p>1.2. Organizon programin e vizitave të delegacioneve të nivelit të lartë nga jashtë;</p> <p>1.3. Përpilon programin e vizitave të personaliteteve të larta shtetërore të Kosovës jashtë;</p> <p>1.4. Përgatit takimet e nivelit të lartë me Ministrin/en e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;</p> <p>1.5. Përkujdeset për ceremonialin diplomatik;</p> <p>1.6. Organizon ceremoni të ndryshme të protokollit;</p>	<p>1. Duties and responsibilities of the Division for Ceremonial shall be as follows:</p> <p>1.1. Draft the Division's program;</p> <p>1.2. Organize visit program of high-level delegations from abroad;</p> <p>1.3. Draft the visits program of high state personalities of Kosovo abroad;</p> <p>1.4. Prepare high level meetings with the Minister of Foreign Affairs and Diaspora;</p> <p>1.5. Take care of diplomatic ceremonial procedures;</p> <p>1.6. Organize various protocol ceremonies;</p>	<p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za ceremonije:</p> <p>1.1. Izrađuje plan i program odseka;</p> <p>1.2. Organizuje program poseta delegacija visokog nivoa iz inostranstva;</p> <p>1.3. Izrađuje program poseta visokih državnih ličnosti Kosova inostranstvu;</p> <p>1.4. Priprema sastanke na visokom nivou sa ministrom inostranih poslova i dijaspore;</p> <p>1.5. Vodi računa o diplomatskoj ceremoniji;</p> <p>1.6. Organizuje razne protokolarne ceremonije;</p>

<p>1.7. Organizon pritje dhe përcjellje të personaliteteve të larta shtetërore në Aeroportin e Prishtinës;</p> <p>1.8. Përkujdeset për ceremonitë e festave shtetërore;</p> <p>1.9. Përkujdeset për ceremonialin e dorëzimit të letër-kredencialeve të Presidenti/ja i/e Republikës së Kosovës për ambasadorë të rinj, të akredituar në Kosovë.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit të Ceremonialit raporton te drejtori i Departamentit të Protokollit të Shtetit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin e Ceremonialit është katër (4).</p>	<p>1.7. Organize receptions and escorts of high state personalities at Prishtina Airport;</p> <p>1.8. Take care of state holiday ceremonies;</p> <p>1.9. Take care of the ceremony of handing over the credentials to the President of the Republic of Kosovo for new ambassadors, accredited in Kosovo.</p> <p>2. Head of the Division for Ceremonial shall report to the Director of Department of State Protocol.</p> <p>3. The number of employees in the Division for Ceremonial shall be four (4).</p>	<p>1.7. Organizuje prijeme i pratnju visokih državnih ličnosti na prištinskom aerodromu;</p> <p>1.8. Brine o ceremonijama državnih praznika;</p> <p>1.9. Brine o ceremoniji predaje akreditivnih pisama predsedniku Republike Kosovo za nove ambasadore, akreditovane na Kosovu.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za ceremonije odgovara direktoru Odeljenja za državni protokol.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za ceremonije je četiri (4).</p>
<p style="text-align: center;"><b>Neni 39</b> <b>Divizioni për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatike</b></p> <p>1. Detyrat dhe përgjegjësitë e Divizionit për Korrespondenca dhe Privilegje diplomatike janë:</p> <p>1.1. Të garantojë respektimin e imuniteteve dhe privilegjeve për përfaqësitë diplomatike dhe organizatat ndërkombëtare të akredituara në Republikën e Kosovës, si dhe personelit</p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 39</b> <b>Division for Diplomatic Correspondence and Privileges</b></p> <p>1. Duties and responsibilities of the Division for Diplomatic Correspondence and Privileges shall be as follows:</p> <p>1.1. Guarantee observance of immunities and privileges for diplomatic missions and international organizations accredited in the Republic of Kosovo, as well as their personnel, in accordance</p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 39</b> <b>Odsek za prepisku i diplomatske privilegije</b></p> <p>1. Dužnosti i odgovornosti Odseka za prepisku i diplomatske privilegije:</p> <p>1.1. Da garantuje poštovanje imuniteta i privilegija za diplomatske misije i međunarodne organizacije akreditovane u Republici Kosovo, kao i njihovo osoblje, u skladu sa Bečkom</p>

<p>të tyre, në pajtim me Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Diplomatike dhe Konventën e Vjenës për Marrëdhënie Konsullore, si dhe Ligjin Nr. 03 – L /033 për Imunitetet dhe Privilegjet e Misioneve, Organizatave Ndërkombëtare dhe personelit me status diplomatik të akredituar në Republikën e Kosovës, që nga pajisja me kartela diplomatike dhe shërbim, regjistrimi i automjeteve me targa diplomatike, si dhe sigurimi dhe garantimi i privilegjeve të tjera që u përkasin;</p> <p>1.2. Përgatit konceptin e përpilimit të korrespondencës diplomatike në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin për Çështje Ligjore dhe drejtoritë e tjera;</p> <p>1.3. Përgatitja e teksteve të notave diplomatike, si: nota verbale, nota kolektive, nota qarkore, nota protestuese, nota identike, aide-mémoire-Memorandumet;</p> <p>1.4. Përpilimi i akteve zyrtare diplomatike;</p> <p>1.5. Përgatitë kërkesat për agrément për ambasadorët e propozuar të Republikës së Kosovës;</p> <p>1.6. Përpilimi i letër-kredencialeve dhe letrës revokuese për Presidencë;</p>	<p>with the Vienna Convention on Diplomatic Relations and the Vienna Convention on Consular Relations, as well as Law No. 03-L/033 on the Immunities and Privileges of Missions, International Organizations and personnel with diplomatic status accredited in the Republic of Kosovo, from the provision of diplomatic cards and service, registration of vehicles with diplomatic license plates, as well as the provision and guarantee of other privileges belonging to them;</p> <p>1.2. Prepare the concept of compiling diplomatic correspondence in close cooperation with the Department of Legal Affairs and other directorates;</p> <p>1.3. Prepare texts of diplomatic notes, such as: verbal notes, collective notes, circular notes, protest notes, identical notes, aide-mémoire-Memoranda;</p> <p>1.4. Compile official diplomatic acts;</p> <p>1.5. Prepares agrément requests for the proposed ambassadors of the Republic of Kosovo;</p> <p>1.6. Preparation of credentials and revocation letter for the Presidency;</p>	<p>konvencijom o diplomatskim odnosima i Bečkom konvencijom o konzularnim odnosima, kao i Zakonom br. 03 - L/033 o imunitetima i privilegijama misija, međunarodnih organizacija i osoblja sa diplomatskim statusom akreditovanim u Republici Kosovo, od izdavanja diplomatskih kartica i usluga, registracije vozila sa diplomatskim registarskim tablicama, kao i obezbeđivanja i garantovanja drugih privilegija koje im pripadaju;</p> <p>1.2. Priprema koncept sastavljanja diplomatske prepiske u bliskoj saradnji sa Odeljenjem za pravne poslove i drugim direkcijama;</p> <p>1.3. Priprema tekstova diplomatskih nota, kao što su: verbalne note, kolektivne note, cirkularne note, protestne note, identične note, aide-mémoire-Memorandumet;</p> <p>1.4. Sastavljanje zvaničnih diplomatskih akata;</p> <p>1.5. Priprema zahteve za agremante za predložene ambasadore Republike Kosovo;</p> <p>1.6. Sastavljanje akreditiva i opozivnog pisma za Predsedništvo;</p>
--	---	---



<p>1.7. Përgatitja e teksteve për letër-emërim, të ngarkuar me punë;</p> <p>1.8. Përpilimi i teksteve për kërkesë të konsullit tonë në detyrë;</p> <p>1.9. Përgatitja e shkresave-akteve të kabinetit të Ministrit/es: letërfalënderimet për vizitat e kryera, letëruirimet për festa shtetërore, mesazhe të ndryshme, përgatitja e letrave për raste funerale;</p> <p>1.10. Ndihmon dhe këshillon departamentet përkatëse në MPJD lidhur me përpilimin e shkresave të ndryshme që kanë të bëjnë me marrëdhëniet diplomatike;</p> <p>1.11. Përgatit udhëzime të ndryshme lidhur me përpilimin e korrespondencave të tjera diplomatike;</p> <p>1.12. Përpilon doracakun e termave në marrëdhëniet diplomatike.</p> <p>2. Udhëheqësi i Divizionit për Korrespondenca dhe Privilegje diplomatike raporton te drejtori i Departamentit të Protokollit të Shtetit.</p> <p>3. Numri i të punësuarve në Divizionin për Korrespondenca dhe Privilegje Diplomatiqe është katër (4).</p>	<p>1.7. Prepare texts for appointment letter, charged with work;</p> <p>1.8. Compile texts at the request of our consul in charge;</p> <p>1.9. Prepare letters-acts of the Cabinet of the Minister: appreciation letters for visits conducted, congratulatory letters for state holidays, different messages, prepare letters for funeral occasions;</p> <p>1.10. Assist and advise relevant departments in the MFAD regarding the drafting of various documents related to diplomatic relations;</p> <p>1.11. Prepare various instructions regarding the compilation of other diplomatic correspondence;</p> <p>1.12. Compile the manual of terms in diplomatic relations.</p> <p>2. Head of the Division for Diplomatic Correspondence and Privileges shall report to the Director of the Department of State Protocol.</p> <p>3. Number of employees in the Division for Diplomatic Correspondence and Privileges shall be four (4).</p>	<p>1.7. Priprema tekstova za pismo imenovanja, zaduženih na dužnosti;</p> <p>1.8. Sastavljanje tekstova na zahtev našeg konzula na dužnosti;</p> <p>1.9. Priprema dokumenata-akata Kabineta ministra: zahvalnice za obavljene posete, čestitke za državne praznike, razne poruke, priprema pisama za pogrebne prilike;</p> <p>1.10. Pomaže i savetuje odgovarajuća odeljenja u MIPD-u u vezi sa izradom različitih dokumenata koji se odnose na diplomatske odnose;</p> <p>1.11. Priprema razna uputstva u vezi sa sastavljanjem drugih diplomatskih prepiska;</p> <p>1.12. Sastavlja priručnik izraza u diplomatskim odnosima.</p> <p>2. Rukovodilac Odseka za prepisku i diplomatske privilegije odgovara direktoru Odeljenja za državni protokol.</p> <p>3. Broj zaposlenih u Odseku za prepisku i diplomatske privilegije je četiri (4).</p>
--	---	--

<p style="text-align: center;"><b>Neni 40</b> <b>Departamenti për Çështje Ligjore dhe Traktate</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Article 40</b> <b>Department of Legal Affairs and Treaties</b></p>	<p style="text-align: center;"><b>Član 40</b> <b>Odeljenje za pravne poslove i ugovore</b></p>
<p>1. Misioni i Departamentit Ligjor të MPJD-së është të koordinojë procesin e hartimit të legjislacionit nga fushëveprimi i Ministrisë dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, duke siguruar konsistencën me dispozitat kushtetuese dhe ligjore, si dhe teknika dhe standarde për hartimin e legjislacionit; të sigurojë përafrimin e legjislacionit të Ministrisë me legjislacionin e Bashkimit Evropian - Acquis të BE-së, të ofrojë mbështetje profesionale, këshilla ligjore dhe rekomandime për strukturat e tjera në kuadër të Ministrisë.</p> <p>2. Detyrat dhe përgjegjësitë e Departamentit për Çështje Ligjore dhe Traktate janë:</p> <p>2.1. Koordinon dhe merr pjesë në hartimin e akteve normative në bashkëpunim të ngushtë me Kabinetin e Ministrisë, me departamentet dhe me njësitë e tjera organizative nga fushëveprimtaria e Ministrisë;</p> <p>2.2. Është përgjegjës për finalizimin e projektakteve normative;</p> <p>2.3. Në bashkëpunim me departamentet,</p>	<p>1. The mission of the Legal Department of the MFAD shall be to coordinate the process of drafting legislation within the scope of the Ministry and international agreements, ensuring consistency with constitutional and legal provisions, as well as techniques and standards for drafting legislation; to ensure the approximation of the legislation of the Ministry with the legislation of the European Union - Acquis of the EU, to provide professional support, legal advice and recommendations for other structures within the Ministry.</p> <p>2. Duties and responsibilities of the Department of Legal Affairs and Treaties shall be as follows:</p> <p>2.1. Coordinate and participate in the compilation of normative acts in close cooperation with the Cabinet of the Minister, departments and other organizational units within the scope of the Ministry;</p> <p>2.2. Be responsible for finalizing normative draft acts;</p> <p>2.3. In cooperation with the departments,</p>	<p>1. Misija Pravnog odeljenja MIPD-a je da koordinira proces izrade zakona iz delokruga Ministarstva i međunarodnih ugovora, obezbeđujući doslednost sa ustavnim i zakonskim odredbama, kao i tehnikama i standardima za izradu zakona; obezbeđuje usklađivanje zakonodavstva Ministarstva sa zakonodavstvom Evropske unije – acquis-om EU-a, pruža stručnu podršku, pravne savete i preporuke za druge strukture u sastavu Ministarstva.</p> <p>2. Dužnosti i odgovornosti Odeljenja za pravne poslove i ugovore:</p> <p>2.1. Koordinira i učestvuje u izradi normativnih akata u bliskoj saradnji sa Kabinetom ministra, odeljenjima i drugim organizacionim jedinicama iz delokruga Ministarstva;</p> <p>2.2. Odgovorno je za finalizaciju nacрта normativnih akata;</p> <p>2.3. U saradnji sa odeljenjima,</p>

